



www.qbz.gov.al

Buletini i Njoftimeve Zyrtare I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË



Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2024 – Numri: 36

Tiranë – E hënë, 23 dhjetor 2024

PËRMBAJTJA

	Faqe
Njoftim i Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor nr. 21685/9, datë 23.12.2024	Për ftesë për ofertë për shkëmbim të pronës shtetërore në administrim të DPSHTRR-së, për ofrim shërbimesh publike me pronë private..... 3



NJOFTIM

Nr. 21685/9, datë 23.12.2024

**PËR FTESË PËR OFERTË PËR
SHKËMBIM TË PRONËS SHTETËRORE
NË ADMINISTRIM TË DPSHTRR-së,
PËR OFRIM SHËRBIMESH PUBLIKE
ME PRONË PRIVATE**

Emri dhe adresa e organit propozues:

Emri: Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor
Adresa: Bulevardi “Gjergj Fishta”, pallati “Bjorn”, Tiranë.
Tel./fax: 00355 688015833
E-mail: dpshttrr@dpshttrr.gov.al
Faqja e internetit: www.dpshttrr.gov.al

OBJEKTI

PËR SHKËMBIM TË PRONËS
SHTETËRORE NË ADMINISTRIM TË
DPSHTRR-së, PËR OFRIM SHËRBIMESH
PUBLIKE ME PRONË PRIVATE

Në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 926, datë 24.12.2014, “Për kriteret e vlerësimit të pronës shtetërore, që privatizohet apo transformohet dhe për procedurën e shitjes”, të ndryshuar, kreu III/1, shpallet për shkëmbim, prona si më poshtë:

Nr.	Emërtimi i objektit	Vendndodhja	Nr. i pasurisë	Zona kadastrale	Sipërfaqja e përgjithshme truall+objekt (m ²)	Sipërfaqja ndërtimore (m ²)
1.	Qendra e Kontrollit Teknik Lushnjë (zyra +1 kat me sipërfaqe 227 m ²)	Rruga “Gafurr Muço”, Lushnjë	13/115	8572	960 m ² truall + 227 m ² ndërtesë	227 m ²
2.	Qendra e Kontrollit Teknik, pikë kontrolli, ambient pune 1-katësh me sipërfaqe 1050 m ² dhe sipërfaqe trualli 2300 m ²	Rruga “Gafurr Muço”, Lushnjë	13/116	8572	2300 m ² truall dhe 1050 m ² ndërtesë	1050 m ²

Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor njofton të interesuarit, se kërkon pronë private që të mund të shkëmbehet me pronë shtetërore, e cila është në administrim të DPSHTRR-së, për ofrim shërbimesh publike.

TË DHËNAT E PRONËS SHTETËRORE QË PROPOZOHET TË SHKËMBEHET PËRKUNDREJT PRONËS PRIVATE JANË:

Prona shtetërore që ofrohet për shkëmbim gjendet në rrugën “Gafurr Muço”, Lushnjë.

1. Sipërfaqja totale e truallit është 3260 m², e ndarë në dy pasuri:

- Pasuria me nr. 13/116, zonë kadastrale 8572, me sipërfaqe 2300 m² truall dhe 1050 m² ndërtesë, në pronësi dhe në administrim të DPSHTRR-së, regjistruar në ASHK, nga të cilat:

- 760 m² është kaponi i Qendrës së Kontrollit Teknik;

- 290 m² janë zyrat e punonjësve të Qendrës së Kontrollit Teknik;

- 1250 m² është sipërfaqe e jashtme (pjesa mbrapa e Qendrës së Kontrollit Teknik).

Ndërtesa prej 1050 m² që është në pasurinë nr. 13/116, nuk shfrytëzohet plotësisht. Rreth 2/3 e kësaj ndërtesë janë të shfrytëzueshme nga kontrolli teknik, kurse 1/3 e saj është rrugë kalimi në formë tuneli (e mbuluar) që aksesohet nga mjetet të cilat futen në linjat e kontrollit teknik.

- Pasuria me nr. 13/115, zonë kadastrale 8572, me sipërfaqe 960 m² truall dhe 227 m² ndërtesë, me pronësi “shtet” dhe në përgjegjësi administrimi Qendra e Kontrollit Teknik Lushnjë, regjistruar në ASHK, nga të cilat:

- 227 m² është objekti i DRSHTTR Fier – dega Lushnjë;

- 733 m² është sipërfaqe e jashtme (pjesa nga para e DRSHTTR Fier – dega Lushnjë).

Pasuritë e mësipërme (nr. 13/115, nr. 13/116):

i. nuk janë prona shtetërore të patjetërsueshme sipas përcaktimeve të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar; nuk kanë interes për t’u realizuar projekte investimi sipas përcaktimeve të ligjit nr. 71/2019, “Për Korporatën e Investimeve Shqiptare”; dhe nuk janë

prona objekt i procedurave të tjera të kalimit të pronësisë, sipas akteve ligjore dhe nënligjore të posaçme;

ii. janë prona të lira nga barrët juridike/të drejtat reale hipotekare referuar kartelave të pasurisë të rifreskuara të përcjella nga ASHK-ja;

iii. nuk janë prona objekt gjykimi, pasi për këto prona nuk ka pretendime gjyqësore nga palë të treta, konfirmuar nga prononcimi zyrtar i Avokaturës së Shtetit, sipas të cilit rezultojnë që nuk ka në ndjekje ndonjë proces gjyqësor ku objekt konflikti të jenë pasuritë me nr. 13/115 dhe nr. 13/116.


Të dhëna teknike të objektit:

1. Sipërfaqe totale e pronës – 3260 m²;
2. Godina e Administratës së DRSHTRR Fier – dega Lushnjë – 227 m²;
3. Sipërfaqe totale e jashtme – 1983 m².



Kapanoni për identifikimin teknik të mjeteve:

- Përbëhet nga një kapanon i kontrollit teknik;
- Sipërfaqja e cila shërben për zyra dhe ambiente teknike.
- Kjo sipërfaqe përbëhet nga:
 - ambienti i pritjes për qytetarët;
 - zyra administrative dhe arka në funksion të identifikimit teknik të mjeteve;
 - gardërobë;
 - njëjë sanitare;
 - kuzhinë;
 - magazinë dhe dhoma teknike.




Sistemimi i jashtëm i sheshit nga mbrapa

Sipërfaqja e sheshit nga mbrapa ka përkatësisht dimensionet mesatarisht 52.5 m x 21 m.

Sipas planit të mëposhtëm sheshi përfshin:

- sipërfaqe gjelbërimi;
- sipërfaqe asfaltike për pjesën ku do të qarkullojnë makinat;
- sipërfaqe për parkimin e makinave.



Sistemimi i jashtëm i sheshit nga para

Sipërfaqja e sheshit nga para ka përkatësisht dimensionet mesatarisht 39 m x 22 m.

Sipas planit të mëposhtëm sheshi përfshin:

- sipërfaqe asfaltike për pjesën ku do të qarkullojnë makinat;
- sipërfaqe për parkimin e makinave;
- sipërfaqe e shtruar me trotuar rreth godinës së administratës.

Godina e administratës së DRSHTRR Fier – dega Lushnjë

Sipërfaqja e cila shërben për zyra dhe ambiente teknike.

Kjo sipërfaqe përbëhet nga:

- ambienti i pritjes për qytetarët;
- zyra administrative;
- informacioni dhe regjistrimi i mjeteve;
- arkivi;
- njëjë sanitare;
- ambient teknik;
- vendqëndrimi i rojës;





KRITERET LIGJORE DHE TEKNIKE QË DUHET TË GËZOJË PRONA E RE QË SYNOHET TË PËRFTOHEJ (OBJEKT SHKËMBIMI) JANË:

Kriteret ligjore dhe teknike që duhet të plotësojë prona e re objekt shkëmbimi, me qëllim plotësimin e nevojave për ofrimin e shërbimeve objekt veprimtarie të DPSHTRR-së, DRSHTRR Fier - dega Lushnjë, në kushte sigurie dhe standarde dinjitoze e bashkëkohore janë:

1. TË DHËNA TË PËRGJITHSHME

1.1 Kriteret ligjore:

1. Certifikata e pronësisë së pronës private që do të shkëmbet, duhet të jetë e lirë nga çdo lloj barre mbi pasurinë apo të drejta reale mbi të;

2. Të mos jetë objekt i mosmarrëveshjeve gjyqësore dhe/ose objekt konflikti me palë të treta;

3. Pronat që do të ofrohen të kenë të shlyera detyrimet sipas legjislacionit në fuqi.

4. Nëse prona që ofrohet nuk ka ndërtesë, atëherë ndërtimi i saj duhet të merret përsipër me shpenzimet e veta që të kryhet nga ofertuesi/subjekti i interesuar, sipas kriterëve teknike që kërkon DPSHTRR-ja për ofrimin e shërbimit.

a) OBJEKTIVAT PËR PRONËN DHE OBJEKTIN E RI

Duke u nisur nga qëllimi, për të krijuar ambiente komode dhe të përshtatshme me kërkesa bashkëkohore, për të zhvilluar aktivitetin e veprimtarisë së Drejtorisë Rajonale të Transportit Rrugor Fier – dega Lushnjë, objektivat e pronës së re dhe objektit të ri janë:

1. Kapanon për Kontrollin Teknik të Mjeteve, dega Lushnjë, së bashku me ambientet e shërbimit dhe arkivat.

2. Rrethim dhe sistemim i sheshit funksional, ku rrugët hyrëse dhe dalëse të jenë në mënyrë të tillë që të mos pengojnë mjetet që hyjnë për kryerjen e shërbimeve të ndryshme.

3. Prona të këtë akses të lidhjes me rrjetet inxhinierike të jashtme (lidhja me energji elektrike, ujësjellës, kanalizime, telefoni, internet etj.).

b) KËRKESA TË PËRGJITHSHME

Duke u nisur nga sipërfaqet ekzistuese të kësaj dege rajonale, kërkohet që vendndodhja e re të ketë këto kriteret teknike:

- të ketë një sipërfaqe truall jo më pak se 3200 m²;

- truall të jetë i rrethuar sipas certifikatës së pronësisë dhe të ketë hyrje e qarkullim lehtësisht të aksesueshëm për çdo kategori mjeti (përfshirë dhe mjetet e tonazhit të rëndë);

- prona të ndodhet në pozicion të favorshëm pranë ndonjë rruge kryesore dhe mos të jetë afër zonave të banuara në mënyrë që të shmanget trafiku dhe ndotja në qytet për mjetet e kategorive të ndryshme që do të paraqiten për kryerjen e kontrollit teknik;

- sipërfaqe totale ndërtimi jo më pak se 700 m², e përshtatshme për zyra, shërbime, arkiv dhe linja teknike për kontrollin teknik të mjeteve (përfshirë dhe mjetet e tonazhit të rëndë) etj.;

- të ketë parkim të mjaftueshëm për qytetarët dhe administratën;

- objekti duhet të jetë në kushte optimale, me standarde bashkëkohore dhe të mos ketë nevojë për ndërhyrje, riparime ose rikonstrukcion;

- objekti duhet të ketë funksional sistemin e mbrojtjes ndaj zjarrit, sistemin ngrohje-ftohje, si dhe sistemin e aspirimit;

- objekti duhet të jetë i përshtatshëm që të shërbejë për kontrollin teknik, me 2 (dy) linja teknike për të gjitha kategoritë e mjeteve rrugore;

- objekti duhet të jetë i aksesueshëm edhe nga personat me aftësi të kufizuara (PAK).

Disa nga ambientet e nevojshme për zhvillimin e aktivitetit të Drejtorisë Rajonale të Shërbimeve të Transportit Rrugor Fier – dega Lushnjë, që duhet të jenë në objekt janë, si më poshtë:

- zyrë shërbimesh me sportele;
- ambient pritjeje për qytetarët;
- zyra me postë pune;
- dhomë serveri;
- ambiente arkivimi për dosjet;
- ambient magazinimi;
- tualete;
- kabinë rojë etj.

c) PARAMETRAT TEKNIKE

i. Kapanoni për kontrollin teknik të mjeteve, si dhe ambienteve ndihmëse (zyra, arkiva)

Kapanoni për kontrollin teknik të mjeteve duhet të plotësojë parametrat, si më poshtë:

- me dimension jo më të vogël se 36 m x 12 m dhe lartësi 5 m, me konstruksion metalik;

- 2 (dy) linja teknologjike (gropa) e kontrollit teknik, sipas teknologjisë përkatëse;



- kapanoni duhet të plotësojë parametra të tillë që i gjithë shërbimi të jetë i mbrojtur nga agjentët atmosferikë;

- të shmangen korrenti i ajrit nga efektet e hapjes së dymave;

- kapanoni duhet të jetë i tillë që niveli i gazrave të jetë në parametra që të mos dëmtohet shëndeti i punonjësve (të garantohet ventilimi i plotë i të gjithë ambientit).

Për gropën e kontrollit teknik, si dimensiononi gjatësor, ashtu edhe i tërthorë duhet të kenë instalimet elektrike, drenazhim dhe hidroizolim. Gjithashtu, nuk duhet të mungojnë 2 deri në 3 priza ngarkese të shpërndara përgjatë saj.

Ndriçimi të garantohet me parametra optimale dhe të mbështetet kryesisht në atë natyral, por që duhet të jetë i disponueshëm edhe ndriçimi me energji elektrike. Instalimet elektrike për ndriçimin duhet të merren në konsideratë, jo vetëm në lartësi ose gjysmë lartësi, por dhe në gropën gjatësore.

Kapanoni duhet të jetë me konstruksion metalik, me veshje e mbulesë me material të lehtësuar.

Dyert e hyrje-daljeve (qepenat) me gabarite 400 x 500 cm (h). Të dyja hapje-mbylljet duhet të jenë elektrike (pavarësisht nga hapja e dymave, ambientet përsëri duhet të kenë një derë emergjence, për një mosfunksionim qepenash).

Kuotat e kapanonit kundrejt shesheve të plotësojnë kërkesat e tilla që të mos lejojnë hyrje të ujërave nga jashtë brenda, por edhe hyrja në kapanon të jetë sa më funksionale.

Kapanoni të jetë i tillë që të mund të pastrohet edhe me ujë të rrjedhshëm (me kullim të brendshëm).

Zyra administrative duhet të ketë një portë për të komunikuar me kapanonin drejtpërdrejt, jo nga portat hyrëse ose dalëse të mjeteve. Gjithashtu, nga zyra duhet të ketë një shikueshmëri relativisht të plotë të të gjithë procesit të shërbimit që kryhet në kapanon (mundësisht fasada direkte të jetë prej xhami).

Ambientet të ofrojnë siguri për ruajtjen e dokumentacionit, i cili duhet të jetë domosdoshmërisht në zyrën administrative.

Ambienti ndihmës i kapanonit (zyra)

Një pjesë e sipërfaqes ndërtimore do të shfrytëzohet për ambientet e zyrave dhe arkivave të cilat duhet të përfshijnë:

- zyrë me 2 poste arke të siguruar përpara me xham;

- ambient pritjeje për qytetarët;

- zyrë me 1 post pune për punonjësit e kontrollit teknik;

- dhoma e serverit;

- ambient ndërrimi i uniformës për punonjësit e kontrollit teknik;

- ambient ngrënie për punonjësit e kontrollit teknik;

- ambiente arkivimi për dosjet;

- ambient për magazinë;

- tualete.

Ambientet për zyrat e degës Lushnjë

Ambientet e kërkuara bazuar në strukturën aktuale janë:

- 2 poste arke të siguruar përpara me xham.

- 1 post shërbimi + fotografimi (do të merret parasysh balancimi i dritës për foto);

- ambient pritjeje për qytetarët;

- ambient për magazinë;

- ambiente arkivimi për dosjet;

- tualete.

ii. Kabinë rojë

Duhet të ketë një kabine rojë/*infopoint* në hyrje të QKT-së për të drejtuar dhe për të orientuar qytetarët.

iii. Sistemimi i jashtëm

Bazuar në dimensionet e sheshit ekzistues dhe në vështirësinë që hasin mjetet e rënda gjatë manovrimit në pronën ku ushtron aktivitetin dega Lushnjë, kërkohet që gjerësia e pronës të jetë jo më e vogël se 25 m, në mënyrë që aksesit dhe lëvizshmëria të mos krijohet vështirësi në këtë kategori mjesh.

Gjithashtu, sistemimi i jashtëm të ketë minimumi 25 vende parkimi në funksion të qytetarëve dhe të administratës.

2. Ofertat që do të paraqesin subjektet e interesuara përbëhet nga dokumentacioni i mëposhtëm:

- Kërkesa/dakordësia e ofertuesit/subjektit të interesuar për të shkëmbyer pronën;

- Ofertuesi/subjekti i interesuar duhet të vërë në dispozicion një kopje të noterizuar të certifikatës së pronësisë së bashku me dokumentacionin shoqërues: kartelë dhe hartë treguese të përditësuar, brenda 3 (tre) muajve të fundit, të pronës që pretendon të shkëmbejë;

- Vërtetimin nga autoriteti përkatës për regjistrimin e pasurisë së paluajtshme, për statusin juridik të sipërfaqes së tokës dhe objektit (godinës);



- Deklaratën materiale nga pronari i pasurisë së paluajtshme që nuk ka konflikt me palë të treta;

- Ofertuesi/subjekti i interesuar duhet të vërtetojë që ka shlyer të gjitha detyrimet, sipas legjislacionit në fuqi;

- Plan-rilevimi të pronës private i propozuar për shkëmbim i hartuar nga një topograf i licencuar;

- Të dorëzohet raporti i ekspertit vlerësues mbi vlerën e pronës private që ofrohet për shkëmbim, të hartuar nga eksperti vlerësues i pasurisë së paluajtshme. Vlera e pronës që do të shkëmbehet me pronën shtetërore nuk duhet të jetë më e vogël sesa ajo që jepet përkundrejt saj. Nëse vlera e pronës që përfitohet është më e ulët, subjekti përfitues duhet të dëshmojë aftësinë financiare për të paguar ekuivalentin në lekë të diferencës ndërmjet dy vlerësimeve.

- Në rast se prona private është në pronësi të një shoqërie tregtare, atëherë ofertuesit/subjekti i interesuar paraqet edhe:

i. certifikatën e regjistrimit dhe certifikatën historike të regjistrimit të subjektit në QKB;

ii. NIPT-in/NUIS-in dhe vërtetimin nga dega e tatimeve, se subjekti ka shlyer detyrimet tatimore dhe sigurimet shoqërore;

iii. vërtetimin se nuk është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë, ose është nën hetim apo ndjekje penale për kryerjen e veprave penale; këtu përfshihet çdo anëtar i një organi administrativ, drejtues ose mbikëqyrës i një subjekti propozues, aksionar ose ortak i tij, ose person që ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda tij.

- DPSHTRR-ja (komisioni/grupi përkatës) rezervon të drejtën për verifikimin në vend të godinës dhe të truallit për të verifikuar përputhjen me kriteret e kërkuara.

Ky dokumentacion të paraqitet në një zarf, të mbyllur, nënshkruar nga ofertuesi/subjekti i interesuar, me mbishkrimin: “Ofertë për shkëmbim prone”, dhe i dorëzohet Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor Tiranë, në datën dhe në orën e hapjes së përcaktuar në këtë njoftim. Në ofertën e tij, ofertuesit/subjekti i interesuar duhet të paraqesë të dhënat e plota të personit të kontaktit.

Dokumentet duhet të jenë origjinale ose fotokopje e noterizuar.

Vendi i dorëzimit të ofertave:

Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor, Zyra e Protokollit, me adresë: bulevardi “Gjergj Fishta”, pallati “Bjorn”, Tiranë; tel.: +355 69 801 5 833.

Ofertat dhe dokumentacioni i pronës dorëzohet nga të interesuarit/ofertuesit, fizikisht, me postë ose dorazi, brenda afatit të përcaktuar në vendin, adresën përkatëse.

Afati kohor për dorëzimin e ofertave nga ofertuesit/subjektet e interesuara do të jetë 21 ditë kalendarike nga e nesërmja e datës së publikimit të këtij njoftimi në faqen zyrtare të QBZ-zë (Buletini i Njoftimeve Zyrtare) dhe në faqen zyrtare të Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit (MEKI).

Buletini i Njoftimeve Zyrtare shpërndahet falas në çdo pikë të Postës Shqiptare.
Përmbajtja e Buletinit Zyrtar mund të konsultohet falas dhe pranë Qendrës së Botimeve Zyrtare.

Tiranë, 2024

